



MAJ
2023



Advocacy Center
for **Democratic Culture**

BULETINI

Buletini i majit thekson aktivitete të rëndësishme duke përfshirë seminarin mbi bashkëpunimin strategjik ndërmjet Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) dhe Institucionit të Avokatit të Popullit, një konferencë për bashkëpunimin ndëretnik, fushatat e vazhdueshme në rrjete sociale që promovojnë të drejtat e punës dhe ndihmën juridike falas, dhe pjesëmarrjen aktive në iniciativat mjedisore.



Advocacy Center
for Democratic Culture

Social networks



+381 (0) 64 11 77 871
+383 (0) 44 53 98 52
office@acdc-kosovo.org

Seminar mbi aspektet strategjike të bashkëpunimit ndërmjet OSHC-ve dhe Institucionit të Avokatit të Popullit



Nga data 3 deri më 5 maj 2023, OJQ ACDC organizoi seminarin tre-ditor në Durrës, Shqipëri, me qëllim të fuqizimit të bashkëpunimit strategjik midis Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) dhe Institucionit të Avokatit të Popullit.

Seminarin ofroi një mundësi për pjesëmarrësit që të përfshihen në diskutime të thella mbi tema të ndryshme thelbësore të të drejtave të njeriut. Rezultatet e këtyre diskutimeve dhe aktivitetëve u përpiluan në një plan pune gjithëpërfshirës, duke përshkruar aktivitetet e planifikuara për Forumin për Dialog të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Organizatave të Shoqërisë Civile për vitin 2023.

Seminarin u organizua në kuadër të projektit "Mbështetje e mëtejshme për qasje në Drejtësi dhe të Drejta të Njeriut në Rajonin e Mitrovicës", financuar nga UNMIK-u.

Konferencë për bashkëpunimin ndëretnik ndërmjet komuniteteve



Në kuadër të projektit "Promovimi i Dialogut Ndëretnik në Qeverisjen Lokale", të financuar nga NED, OJQ ACDC realizoi konferencën për bashkëpunimin ndëretnik ndërmjet komuniteteve në Zveçan dhe Mitrovicën e Veriut. Konferenca u fokusua në bashkëpunimin ndëretnik, ku u diskutua për ndikimin e politikës në jetën e përditshme dhe sfidat me të cilat përballet. Panelistët ishin Lulzim Peci nga Zyra për Komunitete në Komunën e Zveçanit, Ines Aljoviq Mihajloviq nga Komiteti për Komunitete në Komunën e Zveçanit dhe Bekim Ismaili, Koordinator i Projektit të CSSP, të cilët ndanë njohuri të vlefshme dhe theksuan rëndësinë e promovimit të mirëkuptimit, dialogut dhe bashkëjetesës ndërmjet komuniteteve në rajon.

Pastrimi i brigjeve të lumit në Leposaviq

ACDC së fundi realizoi iniciativën për pastrimin e brigjeve të lumit në Leposaviq, duke demonstruar përkushtimin tonë për mbrojtjen e mjedisit dhe një të ardhme më të gjelbër. Ky aktivitet është realizuar në kuadër të projektit "Forcimi i vetëdijes mjedisore në veri të Kosovës", i zbatuar në kuadër të programit "Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore në Kosovë" (IWRM-K), financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), dhe zbatuar nga Skat Consulting Ltd. (Zvicër) në konsorcium me Agjencinë e Mjedisit Austria (EAA).

Filluan seancat e trajnimit gjyqësor për praktikantët në Gjykatë

Praktikantët e angazhuar në projektin "Rritja e transparencës dhe sundimit të ligjit në komunitetet me shumicë serbe në Kosovë" kanë filluar sesionet trajnuese për simulimet e gjyqimit të vetëm. Këto sesione trajnimi janë krijuar për të ofruar përvojë praktike dhe për të përsëritur dinamikën e procedurave reale në sallën e gjyqit. Sesionet e trajnimit do të lehtësohen nga profesionistët ligjor me përvojë, të cilët do të ofrojnë udhëzime dhe mentorim për praktikantët gjatë gjithë procesit.



Fushatat e vazhdueshme në rrjetet sociale

Aktualisht jemi duke zhvilluar dy fushata të vazhdueshme në rrjetet sociale. Fushata e parë fokusohet në të drejtat e punës së grave shtatzëna dhe nënave të reja, duke rritur ndërgjegjësimin për pushimin e lehonisë dhe të drejtat e tyre në vendin e punës.

Fushata e dytë synon të promovojë ndihmën juridike falas, të nxjerrë në pah rëndësinë e mbështetjes ligjore të qasshme për individët në nevojë dhe të prezantojë shërbimet e ofruara nga Agjencia Kosovare FLA.



Seria e Op-Ed-ëve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë

Kemi kënaqësinë të prezantojmë një seri të Op-Ed-ëve, të fokusuara në çështjet thelbësore të të drejtave të njeriut në Kosovë, duke u ofruar të rinjve të shprehin mendimet e tyre dhe të angazhohen në mënyrë aktive në zgjidhjen e çështjeve sociale. Ljiljana Petronijević, e diplomuar në drejtësi, shkroi një artikull duke trajtuar shpronësimin në veri të Kosovës.



Shenimi i Ditëve Ndërkombëtare

Shikoni deklaratat për Ditën e Majit, Ditën e Evropës dhe Ditën Botërore për Diversitetin Kulturor për Dialog dhe Zhvillim.



OJQ ACDC ka angazhuar një koordinatorë të re projekti. Jelena Sofronijevic sjell përvojë të gjerë si aktiviste në sektorin civil dhe publik. Si pjesëmarrëse aktive në nisma të ndryshme mjedisore, Jelena do të udhëheqë projektet tona që synojnë promovimin e mbrojtjes së mjedisit.



Anëtarët e ekipit tonë morën pjesë aktive në ngjarje të ndryshme

Anëtarët e ekipit tonë Snezana Vukicevic dhe Lulzim Hakaj u nderuan të merrnin pjesë në ngjarjen e ndërtimit të besimit në Kosovë, të organizuar nga UNMIK, në Klan Arena në Prishtinë më 11 maj. Ngjarja dha një mundësi të vlefshme për t'u angazhuar me të pranishmit dhe për të shfaqur punën tonë drejt promovimit përfshirjen dhe ndërtimin e paqes në Kosovë.



Aleksandar Rapajiq, drejtor programi, morri pjesë në seminarin e organizuar nga 19 deri më 21 maj, nga OJQ Aktiv me temën e drejtësisë dhe masave alternative të dënimit në Prizren. Seminari mbledhi së bashku gjykatat, gjyqtarët, seksionin e drejtësisë së UNMIK-it dhe organizatat e shoqërisë civile (OSHC) nga Kosova. Ky seminar u organizua në kuadër të projektit "Mbështetje e mëtutjeshme për qasje në drejtësi dhe të drejtat e njeriut në rajonin e Mitrovicës", mbështetur nga UNMIK-u dhe zbatuar nga OJQ ACDC dhe OJQ Aktiv.



Aleksandar Rapajiq, Drejtor i Programit, mori pjesë në një konferencë të organizuar nga Zyra për Çështjet e Komunitetit në Hotel Sirius më 11 maj. Konferenca kishte për qëllim të bashkojë zyrtarët komunalë nga Zyra për Komunitete dhe Kthim, si dhe OJQ-të që punojnë me komunitetet joshumicë në Kosovë.

Anëtarët e ekipit të ACDC, Snezana Vukicevic dhe Jelena Sofronijevic, morën pjesë në panairin e aftësive të mbajtur në Shtëpinë e Evropës në Mitrovicën e Veriut më 10 maj dhe prezantuan punën dhe iniciativat tona.



Sllobodan Stosiq, Menaxher i Programit, mori pjesë në konferencën fillestare të Raportit të Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut në vitin 2022, të publikuar nga Rrjeti për të Drejtat e Njeriut. Konferenca e fillestare shërbeu si një platformë për të paraqitur dhe diskutuar gjetjet dhe rekomandimet e raportit.

Sllobodan Stosiq, Menaxher i Programit mori pjesë në konferencën për Krimet e Gjelbërta dhe Ecojustice në Universitetin e Utrecht-it, Holandë, më 25 dhe 26 maj 2023. Konferenca ofroi një mundësi unike për studiues nga disiplina të ndryshme nga e gjithë bota për të prezantuar dhe diskutuar punën e tyre.



Projektet e reja

Kemi kënaqësinë të njoftojmë për dy projekte të reja të financuara nga Fondi për Zhvillim në Komunitetit (CDF). Projekti i parë, i titulluar "Përmirësimi i kapaciteteve të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas në veri të Kosovës", synon të përmirësojë bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve joshumicë në veri të Kosovës dhe Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas. Projekti synon të përmirësojë kushtet për mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe të përmirësojë cilësinë e shërbimeve të ofruara nga Agjencia. Ky projekt është pjesë e programit JUST REACT të zbatuar nga CDF dhe Grupi për Studime Ligjore dhe Politike (GLPS), financiar nga Komisioni Evropian.

Më 23 maj, OJQ ACDC mori pjesë në një ceremoni nënshkrimi të kontratës dhe takimin e fillimit me Fondin e Zhvillimit të Komunitetit (CDF) në kuadër të projektit HumanRightivism. Ky projekt, i financiar nga Ambasada e Suedisë në Prishtinë dhe i zbatuar nga CDF, synon të mbështesë dhjetë Organizata Joqeveritare në përpjekjet e tyre për të adresuar çështje të ndryshme të të drejtave të njeriut, duke përfshirë avokimin dhe mbrojtjen e grupeve vulnerabël. Për OJQ ACDC, projekti është planifikuar të fillojë më 1 qershor dhe do të vazhdojë për një kohëzgjatje prej gjashtë muajsh.



Komunikata për media

Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike dënoi ashpër inkursionin e fundit të dhunshëm të forcave të Policisë Speciale të Kosovës në ndërtesat e vetëqeverisjes lokale në veri të Kosovës.

Ne shprehëm shqetësim të thellë për përdorimin e forcës fizike, veçanërisht ndaj grave, dhe i konsiderojmë këto veprime si të dëmshme për procesin e pajtimit dhe normalizimit të marrëdhënieve. Në dritën e këtyre zhvillimeve, i bëjmë thirrje urgjentisht Qeverisë së Kosovës që të ndërpresë veprimet e njëanshme dhe të tërheqë menjëherë njësitë speciale nga komunat në veri të Kosovës.

Gjatë vizitës së tij të fundit në Kosovë, Charles Fries, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm për Paqe, Siguri dhe Mbrojtje i Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm (EEAS), u takua me përfaqësues të ndryshëm të OJQ-ve, duke përfshirë ACDC, Aktiv dhe NSI nga Mitrovica e Veriut. Qëllimi i takimeve ishte diskutimi i situatës në veri të Kosovës.

ACDC në media

Dushan Radakoviq për "RTS" për kryetarët e sapozgjedhur në veri të Kosovës

PTC

Dushan Radakoviq për "Kosovo Online" mbi Ligjin e Kosovës për Shpronësimin

Kosov ONLINE

